

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: Rikonstruktion Kopshti “Ton Alimhilli”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45214100-1 - Punime ndërtimi për kopështe femijësh,

VLERA E FONDIT LIMIT: 38,330,201 (Tridhjetë e tete milion e treqind e tridhjetë mijë e dyqind e nje) **lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Shkodër** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:
 - a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
 - b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe si dhe në Ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022-2023-2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës që prokurohet dhe konkretisht **38,330,201** (Tridhjetë e tete milion e treqind e tridhjetë mijë e dyqind e një) **lekë pa tvsh**.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", "*Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën*", "*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës*", si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/b, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.*

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar

atë ne kohe dhe ne përputhje me specifikimet teknike te kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **38,330,201** (Tridhjetë e tete milion e treqind e tridhjetë mijë e dyqind e një) **lekë**.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit **nr. 29/2023** “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave **Nr. 26, datë 08.09.2023**, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.” pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

2.2.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2022-2023-2024 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 *”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar”* (i ndryshuar).

Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin **2025** (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2025.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet qe ushtrojne aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **19,165,100**(Nentembedhjetë milion e njeqind e gjashtedhjetë e pese mijë e njeqind) lekë dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
 - b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht **76,660,402** (Shtatedhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtedhjetë mijë e katerqind e dy)leke.
- Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me sektorin publik,operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikaten e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Akt kolaudimi objekti;
 - Çertifikaten e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
 - Fature tatimore perkatëse të **deklaruar në organet tatimore**.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4.. *ne lidhje me aftësite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomike zoterojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të pershtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomike të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të pershtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”...Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti*

kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat **50%** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose **dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet**, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndermjet kufirit të ulët dhe të lartë monetar, punët e mëparshme të ngjashme janë minimalisht në vlerat **50%** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose **dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet**, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar dhe përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39, pika 8 *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Sipas këtij neni, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), „, Udhezimi i K.M nr.2 ,datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Udhezimin Nr.3 datë 15.02.2001 “Për Mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” te ndryshuar, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës për të vertetuar kërkesat e përcaktuara në nenin 39 pika 5/a dhe b, duhet të paraqesin Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, kontratat e sipërmarrjes, situacionet përfundimtarë, aktin e kolaudimit, Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim për punët e kryera me entet publike, që Autoriteti Kontraktor të bindet që operatori ekonomik me anë të

dokumentacionit të paraqitur ploteson kriterin për punë të ngjashme ku shihen zërat e punimeve që ka realizuar, koha e realizimit, dokumentacioni i kolaudit dhe marrjes në dorezim të objektit si dhe vlerësimi i dhënë nga Autoriteti Kontraktor, elemente të nevojshme për të gjykuar për plotësimin e kriterëve për punë të ngjashme.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Punime të përgjithshme ndërtimi:

Kategoria NP-1 Niveli A “Punime germimi në tokë”

- Kategoria NP-2 Niveli A “Ndertime civile dhe industriale”
- Kategoria NP-7 Niveli A “Ujesjellesa, gazsjellesa,
- Kategoria NP-11 Niveli A “Nderime për N/Stacionet....
- Kategoria NP-12 Niveli A “Punime të inxhinierisë së mjedisit”

Punime speciale ndërtimi:

- Kategoria NS-1 Niveli A “Punime për prishjen e ndertimeve ...”
- Kategoria NS-2 Niveli A “Impiante H/Sanitare...
- Kategoria NS-4 Niveli A “Punime rifiniture të muratës dhe të lidhura me to....
- Kategoria NS-8 Niveli A “Ndertime p/f beton/arme, struktura metalike dhe druri
- Kategoria NS-12 Niveli A “Impiante teknologjik termik ...
- Kategoria NS-13 Niveli A “Impiante dhe linja telefonie..
- Kategoria NS-14 Niveli A “Impiante të brendshme elektrike, telefonike..”

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislativës në fuqi.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42,

datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.." Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zërat e punimeve të ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
Kategoria NP-1	Punime germimi	Ne preventiv zeri nr 1 Kap 1	Niveli A	53,450 leke pa tvsh
<u>Kategoria NP-2</u>	Ndertime civile dhe industriale	Ne preventiv zeri nr 27,28,29,61,71,76,79	Niveli A	3,831,180 leke pa tvsh

<u>Kategoria NP-7</u>	Ujesjelles,gazsjelles,...	Ne preventiv zeri nr 60,Kap 9,zeri nr74,75,Kap 15,zeri nr 189Kap 19	Niveli A	865,923 leke pa tvsh
<u>Kategoria NP-11</u>	Ndertime per N/stacione,kabinat e transformatoreve...	Ne preventiv zeri nr 230 Kap 20	Niveli A	105,000 leke pa tvsh
<u>Kategoria NP-12</u>	Punime te inxhinierise se mjedisit	Ne preventiv zeri nr 80,81 Kap 18	Niveli A	55 ,035 leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-1</u>	Punime per prishjen e ndertimeve	Ne preventiv zeri nr (3-10)Kap 2,zeri nr (16-17) Kap4,	Niveli A	896,563leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-2</u>	Impiante H/Sanitare	Ne preventiv zeri nr (30-43)Kap6,zeri nr (132-136) Kap 19,zeri nr (173-188,193-194)Kap 19,zeri nr(202-207)Kap20,	Niveli A	2,664,838 leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-4</u>	Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to ..	Punimet sipas preventivit zeri nr(11-15)Kap3,zeri nr(16-24)Kap4,zeri nr (25-26)Kap5,zeri nr(44-50)Kap7,zeri nr 62 Kap 10,zeri nr (72-73) Kap 14,zeri nr 196Kap19	Niveli A	15,443,118 leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-8</u>	Ndertime p/f ,b/a stuktura metalike dhe druri	Ne preventiv zeri nr (63-68) Kap11,zeri nr (69-70)Kap12,zeri nr (77-78)Kap17,	Niveli A	3,630,671 leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-12</u>	Impiante teknollogjik ,termik dhe te kondicionimit	Ne preventiv zeri nr (150-169),zeri nr (217-227) Kap20	Niveli A	3,724,668 leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-13</u>	Impiante she linja telefonie dhe telekomunikacioni	Ne preventiv zeri nr (114-119) zeri nr (137-149),zeri nr 198,zeri nr (208	Niveli A	2,239,472 leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-14</u>	Impiante te brendshme elektrike,telefonikr..	Zeri nr (51-58) kap 8,zeri nr 59 Kap9,zeri nr (82-113),zeri nr (120-131)Kap19,zeri (170-172) Kap19,zeri nr 197,zeri nr (199-201),Kap20	Niveli A	2,859,949 leke pa tvsh

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt te pakten:

1(nje) inxhinier ndërtimi
1(nje) inxhinier elektrik
1(nje) inxhinier mekanik
1 (nje) Inxhinier Elektronik
1 (nje) Arkitekt

Inxhinieret e mësipërm duhet të jenë të siguar dhe të figurojnë me kohë të plotë në listëpagesat perkatese E-Sig për të paktën **3(tre) muajt e fundit**

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Kontratën individuale të punës, Diplomën e inxhinierëve të mësipërm.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

- Inxhinieri Elektronik Drejtues teknik duhet të jete i pajisur me - Certifikatë **CISCO CCNA** (Cisco Certified Network Associate) ose ekuivalent (per Nderlidhjen e pajisjeve te rrjetit Kompjuterik dhe Telekomunikacionit), e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë. * Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesin e kerkuar si me siper, emer/mbiemer, numrin dhe daten e certifikates, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument.

Argumentimi: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar lejon vendosjen e kriterëve të kualifikimit për të garantuar cilësinë e punimeve dhe shërbimeve, për sa kohë ato janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës kërkesa e mesiperme eshte e bazuar ne menyre te rregull me zerat e preventivit dhe kërkesa e mesiperme per kualifikim garanton cilesine dhe zbatimin e rregullt te kontrates referuar zerave te ndryshme te rrjetit kompjuerik dhe Inxhinieri Mekanik Drejtues teknik duhet të jete i pajisur me - Certifikatë **“Sistemët HVAC”** e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë. * Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesin e kerkuar si me siper, emer/mbiemer, numrin dhe daten e certifikates, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme eshte bere bazuar ne zerat e preventivit dhe specifikimet teknike ku kerkohet certifikimi i Inxhinierit per njohen me zerat e zbatimit te kontrates per ndjekjen e kontrates Telekomikacionit.

- Inxhinieri Elektrik Drejtues teknik duhet të jete i pajisur me - Certifikatë **CCTV** (Per rrjetin e kamerave) e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë. * Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesin e kerkuar si me siper, emer/mbiemer, numrin dhe daten e certifikates, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale,

autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” ne nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar.

Eshtë kërkuar inxhinier ndertimi për zbatimin e punimeve ne perputhje me zerat e punimeve te preventivit, projektit, specifikimeve teknike qe do te zbatohen dhe si dhe kategorive perkatese ne licencen perkatese te zbatimit,. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve qe vendosen ne objekt

Eshte kerkuar inxhinier elektrik ne perputhje me zerat e punimeve te preventivit zeri nr18 Kap 8,zeri nr 28 Kap 8..

2.3.4 Vetdeklarimin nga inxhinier i ndërtimit, elektrik ,mekanik, elektronik, arkitekt se jane te disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar ne Rekomandimin Nr. 6732 date 21.10.2020 ”Mbi Problematikat e konstatuara gjate monitorimit nga APP”

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë me profesion inxhinier ndertimi dhe të deklaroje se ai eshte i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma.

Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishem gjate gjithë kohes qe do te kryhen punimet ne objekt ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas përqindjes se bashkepunimit.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ne nenin 39, pika 6, gërma c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Eshte vendosur ky kriter duke u bazuar ne ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar,pasi per cdo objekt zbatimi duhet te kete drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij ne perputhje me kete ligj dhe vendim Nr.312, datë 5.5.2010”Për miratimin e rregullores "për sigurinë në kantier"

Duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohe ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.6 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si: 1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili nga Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" sipas zerave të punimeve që marrin persiper në realizim të kontratës sipas aktmarreveshjes).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohe sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Minimumi 1 (nje) person i certifikuar “Koordinator per sigurinë ne pune” leshuar nga organe te akredituar te njohur nga Republika e Shqiperise. Kërkesa per Koordinatorit per Sigurine ne Pune, mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM-ne Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores - Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë, sidomos ne kete kontrate ku dhe numuri I punojesve te kerkuar per realizimin e saj eshte i larte. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM-ne Nr.312/2010 është përcaktuar se: “Punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rrezikët, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.”

2.3.7 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar: minimumi 5 (**pesë**) persona te certifikuar per “Punime ne skela” leshuar nga organe te akredituar nga Republika e Shqiperise. njësia e prokurimit vlerëson se kjo kërkesë është e domosdoeshme, duke qënë se bazuar në preventivin e punimeve kemi të bëjmë me kryerje të punimeve në lartësi (mbi 2 m) me anë të skelerive, shkallëve etj., për punimet që do të kryhen në çati dhe fasadat e objektit, kërkesë kjo në zbatim të përcaktimeve të nenit 11 të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, dhe pikës 13 të Aneksit V/ Seksioni II/ Pjesa B e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”, ku për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të paraqesë kontratat e punës (të vlefshme), dhe Çertifikatat përkatëse të punonjësve që do të angazhojë për kryerjen e këtyre punimeve.

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili nga Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (nje) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" sipas zerave te punimeve qe marrin persiper ne realizim e kontrates sipas aktmarreveshjes).

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjesve të siguruar për 3 (tre) **muajt e fundit** duhet te jetë **31 (tridhjetë e një)**.

Lidhur me këte pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese vertetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqerore dhe Shendetsore në të cilin të jetë i percaktuar numri i punonjesve të siguruar për periudhen e mësipërme, shoqëruar me listepagesat perkatese E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shëndetsore.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Numri i punonjesve 31(tridhjetë e një)

Afati 6 (gjashtë) muaj.

Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte $30744:8:132=29.1$ puntore

Nevojiten:

1-Muratori nevojitet per kryerjen e punimeve te ndryshme te ndertimit. Sasia e oreve te punes sipas manualit është: $10143:8:132 = 9,6$ puntore (3spec+6puntore)

2-Suvatuesi nevojitet per kryerjen e punimeve te suvatimit.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $4843:8:132=4.5$ punonjes(2spec+3puntore)

3-Pllakashtruesi nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $2895:8:132=2.7$ punonjes(1spec+2puntore)

4-Specialist gipsi nevojitet per kryerjen e punimeve ne objekt.Sasia e oreve te punes sipas manualit është: $1236:8:132= 1.1$ puntore

5-Bojaxhiu nevojitet per kryerjen e punimeve te bojatisjes.Sasia e oreve te punes sipas manualit është: $586:8:132 =0.55$ puntore

6-Elektricisti nevojitet per kryerjen e punimeve elektrike.Sasia e oreve te punes sipas manualit është: $1028:8:132 = 0.97$ puntore

7-Marangozi nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $1368:8:132=1.2$ punonjes .

8-Hidrauliku nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $820:8:132=0.77$ punonjes

9-Hekurkthyesi nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $619:8:132=0.58$ puntore

10-Mekaniku nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $753:8:132=0.71$ punonjes

11-Specialisti internetit nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $214:8:132=0.2$ punonjes

12-Punonjes instalator nevojitet per kryerjen e punimeve per vendosjen e paisjeve te kaldajave. Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $700:8:132=0.66$ punonjes.

13-Hidroizoluesi nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $235:8:132=0.22$ punonjes

Punetore ndihmesa ne raste leje te zak raporta etj 4 (kater) punonjes

-Shofer 2(dy) punonjes

-Manovrator 1(nje) punonjes

Totali 31(tridhjetë e një) punonjes

Ne lidhje me vërtetimin të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve kjo kerkese eshte e mbështetur në Nenin 39, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjes të pasqyruar në listëpagesa për të paktën **3 (tre) muajt e fundit**, te paisur me kontrate pune (te vlefshme), diplome leshuar nga autoritetet pergjegjese shteterore/organe/institute te akredituar, ose te *kontraktuar posacerisht per te realizuar kete kontrate ne rastin kur makinerite jane me qera per manovratorët*, ku nga këta të jenë të paktën::

- | | |
|------------------------|-----------------|
| • Murator | 2 (dy) punonjës |
| • Suvatues | 2(dy) punonjes |
| • Pllakashtrues | 1(nje) punonjes |
| • Specialist gipsi | 1(nje) punonjes |
| • Bojaxhi | 1(nje) punonjes |
| • Elektracist | 1(nje) punonjes |
| • Marangoz | 1(nje) punonjes |
| • Hidraulik | 1(nje) punonjes |
| • Hekurkthyes | 1(nje) punonjes |
| • Mekaniku | 1(nje) punonjes |
| • Specialist interneti | 1(nje) punonjes |
| • Instalator | 1(nje) punonjes |
| • Hidroizolues | 1(nje) punonjes |

Për stafin teknik të mësipërm, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. kontratën individuale të punës te vlefshme;
- b. diplomën e shkolles/deshmi nga organe/institute te akredituar që të vërtetojë kualifikimin profesional të punonjesve te mësipërm;
- c. Manovratori duhet të jetë punonjës i specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda (Eskavatorist) ose (Automakinist) dhe për këtë duhet të paraqesin deshmi nga Drejtoria e Sherbimit te Transportit Rrugor.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Nevojiten:

1-Muratori nevojitet per kryerjen e punimeve te ndryshme te ndertimit. Sasia e oreve te punes sipas manualit është: $10143:8:132 = 9,6$ puntore (3spec+6puntore)

2-Suvatuesi nevojitet per kryerjen e punimeve te suvatimit. Sasia e oreve te punes sipas manualit është. Sasia e oreve te punes sipas manualit është: $4843:8:132=4.5$ punonjes(2spec+3puntore)

3-Pllakashtruesi nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit. Sasia e oreve te punes sipas manualit është: $2895:8:132=2.7$ punonjes(1spec+2puntore)

4-Specialist gipsi nevojitet per kryerjen e punimeve ne objekt. Sasia e oreve te punes sipas manualit është: $1236:8:132= 1.1$ puntore

5-Bojaxhiu nevojitet per kryerjen e punimeve te bojatisjes. Sasia e oreve te punes sipas manualit është: $586:8:132 =0.55$ puntore

6-Elektricisti nevojitet per kryerjen e punimeve elektrike. Sasia e oreve te punes sipas manualit është: $1028:8:132 = 0.97$ puntore

7-Marangozi nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit. Sasia e oreve te punes sipas manualit është: $1368:8:132=1.2$ punonjes .

8-Hidrauliku nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit. Sasia e oreve te punes sipas manualit është: $820:8:132=0.77$ punonjes

9-Hekurkthyesi nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit. Sasia e oreve te punes sipas manualit është: $619:8:132=0.58$ puntore

10-Mekaniku nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit. Sasia e oreve te punes sipas manualit është: $753:8:132=0.71$ punonjes

11-Specialisti internetit nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit. Sasia e oreve te punes sipas manualit është: $214:8:132=0.2$ punonjes

Punetore ndihmesa ne raste leje te zak raporta etj 6 (gjashte) punonjes

-Shofer 2(dy) punonje

-Manovrator 1(nje) punonjes

Totali 31 (tridhjetë e një) punonjes

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Te gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe

me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/deshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se.

Kërkesa për deshmitë e manovratoreve bazohet në Urdhërin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”.

2.3.10 Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit:

Nr	Mjetet	Sasia
1	Kamion me vinc deri 6-10 ton (hekuri betonit)	1 copë
2	Autovinc (Catia)	1 copë
3	Autobetoniere (beton pompe) (pllaka e themelit)	1 copë
4	Pompe suvatimi	1 copë
5	Mjet transporti veteshkarkues deri 5 ton (kapac.mbjates)	2 copë
6	Betoniere	1 copë
7	Matrapik	1 copë
8	Skeleri	1000m2
9	Zmerilatrice	1 cope
10	Saldatrice	1 cope
11	Trapano	1 cope
12	Dumper kantieri	1 cope
13	Depozite uji 5000 l	1 cope
14	Helikopter nivelues	1 cope
15	Instrument per punime gjeodezike	1 cope
16	Elektrotrapano	1 cope
17	Elektroorgano	1 cope
18	Kontenier modular i levizshem me panel sanduic per zyren ne kantier	1 cope
19	Kamera HD	4 cope

20	DVI	1 cope
----	-----	--------

Si dëshmi për plotesimin e kësaj pike Operatori duhet të paraqesë:

- i. Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).
- ii. Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit në Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore të blerjes.
- iii. Për të gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.
- iv. Për mjetet e marra me qera që shënohen në regjistra publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Kurse për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Periudha e garancisë për defektet është 2 vjet pas marrjes në dorezim të objektit (hartimit të procesverbalit të marrjes në dorezim dhe çertifikates)

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës.

Mjet transporti vetshkarkues deri 5 ton (ngarkesa)

Transport dhera m^3 $130 \cdot 1.6 = 208$ ton

Transport inerte m³ 350*1.8=630 ton

Transport material te ndryshme -50 ton

Totali 888 ton : 132 = 6.7 ton, mesatarisht 1-2 rrugë në ditë

-Betoniera nevojitet per pregaditjen e llaceve dhe betoneve sipas zerave te preventivit

-Skelerite nevojiten per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit

-Matrapiku nevojitet per realizimin e punimeve te prishjes.

-Skelerite nevojitet per kryerjen e punimeve ne lartesi sipas zërave të preventivit.

-Zmerilatrice nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.

-Saldatrice nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.

-Trapano nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.

-Dumper kantieri nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.

-Autovinci nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.

-Kamion me vinc nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.

-Autobetoniera nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.

-Pompe suvatimi nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.

-Depozite uji 5000 litra nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.

-Helikopter nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.

-Instrument per punime topogjeodezike nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.

-Elektrotrapano nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.

-Elektroorgano nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.

-Kantier modular i levizshem me panel sanduic per zyren ne kantier nevojitet per personelin.

2.3.10 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, per objektin qe prokurohet, te cilat duhet te jene te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe te noterizuara, sipas standardeve:

- Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 9001:2015 e përditësuar (për sistemin e menaxhimit të cilësisë)**, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 14001:2015 e përditësuar (për sistemin e menaxhimit të mjedisit)**, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 45001-2023 e përditësuar (për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)**, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e kërkuara të cilësisë sipas zërave që merr përsipër të realizojë në aktmarrëveshje.

Pranohet edhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me **ISO 9001:2015** me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ose certifikatën për standardin e përditësuar **ISO 45001-2023** ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me **ISO 45001-2018** me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike /Relacioni Teknik grafik i punimeve për këtë procedure janë hartuar nga subjekti i licensuar që ka hartuar edhe projekt/preventivin përkatës të zbatimit duke qenë elemente përbërës të tij dhe janë verifikuar nga specialistët e fushës. Dokumentet janë kontrolluar dhe janë gjetur në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”. Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve që do të realizohen në objekt, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e objektit të punës, në përputhje me nenin 4, pika 3/b dhe neni 36, të LPP (i ndryshuar), dhe të Nenit 39, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në rastet nëse janë përmendur marka prodhimi, burim specifik apo proces i veçantë do të pranohen edhe ekuivalentët përkatës.

Gjatë hartimit të specifikimeve teknike janë marrë në konsideratë kërkesat ligjore të fushës së planifikimit dhe zhvillimit të territorit si dhe normat përkatëse të përcaktuara në aktet nën ligjore në fuqi në fushën e ndërtimit.

Specifikimet teknike janë sipas materialit i cili është publikuar sëbashku me dokumentat.